

## RELACION

### **“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 155/2015, “PËR LOJËRAT E FATIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Përgatitja e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1 dhe 155, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Qëllimi kryesor i projektligjit është rikthimi i kategorisë së Basteve Sportive por tashmë vetëm në formën Online me qëllim formalizimin tregut të lojërave të fatit për këtë kategori loje, duke licencuar subjekte të cilat kanë eksperiencë në ushtrimin e aktivitetit baste sportive.

Garantimin e të ardhurave të mbledhura nga aktiviteti i basteve sportive online në mbështetjeje direkte në fushën e sportit, kulturës, inovacionit dhe teknologjisë së inovacionit por dhe financimin e programeve të mbrojtjes së lojtarit.

#### **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektligj nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, gjatë vitit 2023.

#### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME**

Deri në vitin 2018 (vit kur sipas Ligjit nr. 75/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar u ndalua ushtrimi i veprimtarisë) kanë ushtruar veprimtarinë në kategorinë e “Basteve Sportive” 3 (tre) kompani të cilat ishin licencuar për një afat 10 vjeçar në këtë kategori loje. Kompanitë e basteve sportive e ushtronin aktivitetin në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në pika sekondare të ushtrimit të aktivitetit, në njësi tregëtare kryesisht Bar Kafe, pasi pajiseshin me miratim nga ana e Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit si dhe kanë patur detyrimin të kishin minimalisht një të punësuar për çdo pikë sekondare të ushtrimit të aktivitetit dhe ta deklaronte pranë AMLF-së.

Sipas të dhënave të AMLF numri i pikave sekondare të ushtrimit të aktivitetit për kategorinë e Basteve Sportive në vitin 2018 ka qënë 4214 në të gjithë teritorin e vendit, ndërsa numri i të punësuarve për këtë kategori ka qënë 6700 punonjës.

Me ndryshimet ligjore te vitit 2018 u përcaktua se organizatorët e kategorive “baste sportive”, “baste për garat në pistë” dhe “lojërat elektronike në distancë” nga shoqëri vendase apo të huaja do të ushtronin aktivitetin e tyre deri në datën 31 dhjetor 2018.

Edhe pse aktiviteti i Basteve Sportive u ndalua me ligj ky aktivitet u kanalizua të ushtrohej në të zezë. Nga ana e Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit në kuadër të ushtrimit të detyrave të tij funksionale janë ushtruar kontrole në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 në total 1421 kontrole nga ku janë realizuar konfiskime, procedime penale dhe masa administrative me gjobë për 135 subjekte dhe individ që operonin në mënyrë të jashtëligjshme në tregun e lojërave të fatit.

Gjithshu nga ana e AMLF-së janë raportuar 4035 adresa bastesh të paligjshme pranë AKEP më qëllim mbylljen e këtyre adresave.

Duke rezultuar një shifër e madhe në ushtrimit të aktivitetit të Basteve Sportive në mënyrë informale nga ana e Qeverisë Shqiptare është marrë inisiativa e rikthimit të kategorisë së Basteve Sportive në tregun e lojërave të fatit vetëm në formën e **Basteve Sportive Online**.

Projektligji ndër të tjera propozon si më poshtë:

- Rishikimin e mënyrës së licensimit duke parashikuar kritere më të forta për organizatorët e lojrave të fatit,
- Sigurimi i platformave online të sigurta,
- Sigurimi i mënyrës së regjistrimit të çdo lojtari që luan baste sportive duke patur në kontroll çdo informacion dhe shumë të luajtur;
- Kryerjen e pagesave vetëm nëpërmjet agjentëve financiare;
- Krijimin e komisionit të licensimit si një strukturë vendimarrëse kolegjiale për licencimin e subjekteve që do të ushtrojnë aktivitet në fushën e lojërave të fatit;
- Sigurimi i mbrojtjes së lojtarit, jo vetëm nëpërmjet programeve sociale por dhe nëpërmjet fondit të garancisë për lojtarët; Për krijimin e garancive për fituesit e lojërave të fatit, organizatori i kategorisë “Baste sportive online” është i detyruar të ngurtësojë një fond prej 120 000 000 (njëqin e njëzet milionë) lekësh, por jo më pak se 5% e shumave të luajtura nga lojtarët brenda një viti ushtrimor paraardhës, në një llogari të veçantë bankare, në favor të Ministrisë së Financave, i cili zhbllkohet vetëm me urdhër të ministrit përgjegjës për financat.
- Krijimi i fondit të posaçëm për mbështetje direkte në fushën e sportit, kulturës, inovacionit dhe teknologjisë së inovacionit.
- Këshilli i Mbështetjes së Projekteve i cili do të vlerësojë projektet që do të financohen nga Fondi i Posaçëm.
- Me qëllim formalizimin tregut të lojërave të fatit për këtë kategori loje, duke licencuar subjekte të cilat kanë eksperimentuar në ushtrimin e aktivitetit baste sportive jo vetëm brenda vëndit por dhe ndërkombëtare.
- Ndalohet publiciteti i lojërave të fatit në median e shkruar dhe atë audiovizive. Projektligji rregullon publicitetin e lojërave të fatit, ku ndër risit që sjell është publiciteti i aktivitetit të subjekteve të licencuara të lojërave të fatit në median audiovizive për kategoritë “Baste sportive online”, “Lotari Kombëtare” dhe “Bingo televizive” në kufizim orarësh, si dhe publiciteti për kategorinë “Baste sportive online” në vendet ku zhvillohen aktivitetet sportive, si dhe e drejta që kanë këto subjekte për të qënë sponsor në skuadrat sportive.

- Për krijimin e garancive për shlyerjen e detyrimeve periodike ndaj AMLF-së, organit tatimor etj, organizatori i kategorisë “Baste sportive online” është i detyruar të ngurtësojë një fond prej 50 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, në një llogari të veçantë bankare, në favor të AMLF-së, i cili zhbllkohet vetëm me urdhër të ministrit përgjegjës për financat.”
- Organizatorët e kategorisë “Baste sportive online” derdhin në llogari të Fondit të Posaçëm masën 15 % të të ardhurave bruto nga loja.”

Ky p/ligj shoqërohet dhe me efekte finaciare të cilat janë rrjedhim i taksimit të organizatorëve dhe lojtarit.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1 dhe 155, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE**

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, nuk synon përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian (*acquis communautaire*).

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKT-AKTIT**

Projektligji përbëhet nga 30 nene, të cilët konsistojnë në ndryshime dhe shtesa të dispozitave përkatëse të ligjit nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, si më poshtë:

Në nenin 1 të projektligjit parashikohet që kudo në ligji fjalët “Baste sportive” zëvendësohet me flatët “Baste sportive online”.

Duke qënë se ushtrimi i basteve sportive do të lejohet vetëm online atëherë në ligj do të bëhet zëvendësimi i kategorisë së lojës nga baste sportive në baste sportive online.

Në nenin 2 të projektligjit, parashikohen shtesa dhe ndryshime në nenin 4, si më poshtë:

Pika 6 e nenit 4 ndryshohet si vijon: "6. Baste sportive online” janë bastet e vendosura në faqe interneti ose platformë elektronike të dedikuara, të autorizuar dhe të monitorueshëm të subjekteve të licencuara në përputhje me parashikimet e këtij ligji për ngjarjet sportive ose/dhe lojërat sportive të cilat do të ndodhin në të ardhmen dhe që nuk përfshijnë garat e pistave”.

Në pikën 28 të nenit 4, fjala "bileta" zëvendësohet me fjalët "kuponat elektronike që përmbajnë detajet e lojës së kryer nga klienti."

Pika 30 e nenit 4 do të riformulohet me këtë përmbajtje:

"30. Person i lidhur" është personi i lidhur në marrëdhënie të ngushtë personale, pune apo biznesi me aplikantin, ku përfshihen bashkëshortët, bashkëjetuesit, prindërit, fëmijët apo çdo person i përmendur në certifikatë familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile, si dhe çdo person fizik ose juridik që dihet botërisht se ka ose ka patur marrëdhënie të ngushta biznesi apo janë bashkëpronarë përfitues në persona juridik ose organizma ligjor."

Pika 31 riformulohet si vijon "Programe elektronike për lojëra basti" janë programet softëare të ideuara dhe të ndërtuara nga shoqëritë e licencuara nga AMLF-ja nëpërmjet komisionit të licencave për të ofruar lojën e basteve sportive online".

Pas pikës 44 të nenit 4, shtohen pikat 45 dhe 46, me këtë përmbajtje:

45. "Media elektronike" është ofruesi i shërbimit mediatik i cili përfshin por nuk kufizohet në programe/publikime, përmbajtja e të cilave, nëpërmjet internetit, transmetohet/publikohet në mënyrë ditore ose periodike, me qëllim informimin, argetimin dhe edukimin e publikut.

46. "Agjentet Financiar" janë Posta Shqiptare, Bankat e nivelit të dytë dhe institucionet financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë sipas parashikimeve të licensës së tyre bazuar në ligjin nr.55/2020 "Për shërbimet e pagesave".

Në nenin 3 të projektligjit parashikohet shtesë e pikës 5, pas pikës 4, në nenin 7 të ligjit si më poshtë:

"5. Komisioni i licensimit harton dhe propozon programe të dedikuara për mbrojtjen e lojtarit të cilat miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për çështjet sociale".

Në nenin 4 të projektligjit parashikohen shtesa dhe ndryshime të nenit 9 të ligjit si më poshtë:

Pika 2 e nenit 9 ndryshon si vijon: "2. Ndalohet publiciteti i lojërave të fatit në median e shkruar dhe atë audiovizive"

Pas pikës 2 shtohen pikat pika 2/1, 2/2, 2/3, 2/4, 2/5, 2/6 dhe 2/7 me këtë përmbajtje:

"2/1. Publiciteti lejohet të kryhet nga organizatorët e lojërave të fatit të licencuara në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj,

(i) në median elektronike

(ii) në faqet online të autorizuara të këtyre subjekteve,

(iii) nëpërmjet vendosjes së materialeve vizuale në vende publike shprehimisht të përcaktuara në këtë ligj.

2/2 Publiciteti lejohet të kryhet edhe në median audiovizive nga organizatorët e lojërave të fatit "baste sportive online", "bingo televizive" dhe "lotari kombëtare" në kushtet si vijon:

a) nga organizatorët e lojërave të fatit baste sportive online, gjatë kohës së transmetimit të eventeve sportive të disiplinës futboll si dhe gjatë kohës së transmetimit të programeve sportive të lidhura me këto evente sportive që transmetohen pas orës 22:00, si dhe vetëm

në kushtet e parashikuara në këtë ligj dhe në rregulloren e miratuar nga Komisioni i Licencave,

b) nga organizatorët e lojërave të fatit Lotari Lombëtare dhe Bingo televizive për transmetimet në intervalin kohor ditor 20:00 – 08:00.

2/3. Në rastet e lejuara për publicitetin e aktivitetit të lojërave të fatit, organizatorët e lojërave të fatit kanë të drejtë ta kryejnë atë, vetë ose nëpërmjet kontraktorëve, duke respektuar kushtëzimet e mëposhtme:

a) Publiciteti nuk duhet të cenohet dinjitetin njerëzor;

b) Publiciteti nuk duhet të jetë abuzues dhe i fshehtë;

c) Publiciteti nuk duhet të inkurajojnë konsumatorët për të rinvestuar fitime në lojë fati;

ç) Publiciteti nuk duhet të ketë përmbajtje të pavërtetë apo çorientuese, veçanërisht lidhur me mundësinë e shumën e fitimeve dhe kushtet e pjesëmarrjes në lojë;

d) Publiciteti nuk duhet të japë përshtypjen se pjesëmarrja në lojë është zgjidhje e problemeve financiare apo se pjesëmarrja në lojë sjell sukses social e financiar dhe kontribuon në përmirësimin e reputacionit të individit;

dh) Publiciteti nuk duhet t'iu adresohet të miturve;

e) Publiciteti duhet të përmbajë dukshëm frazën “Lojrat e fatit krijojnë varësi. Kujdes në ushtrimin e tyre të tejzgatur”;

e) publiciteti në median audiovizive është vetëm me fjalë të shkruara në kushtet e parashikuara në rregulloren përkatëse të miratuar nga Komisioni i Licencave.

2/4. Kushtëzimet sa më sipër zbatohen edhe në rastin e publiciteteve brenda ambienteve të autorizuara të organizatorit të lojës kazino dhe kazino të vendosur në hotel me pesë yje dhe resort kazino.

2/5. Subjektet e licencuara për lojëra fati lejohen të sponsorizojnë skuadra sportive si dhe të bëjnë publicitet të aktiviteteve të tyre në vendet ku zhvillohen veprimtari sportive, me përjashtim të eventeve sportive të të gjitha disiplinave për kategoritë nën 21 vjeç.

2/6. Lejohet vendosja e materialeve vizuale, shenjave apo tabelave orientuese nga ana e organizatorit e lojërave të fatit të kategorisë “kazino”/“kazino të vendosur në hotel me pesë yje dhe resort kazino”, vetëm në hyrjen qendrore në kazino . Në çdo rast, tabela mund të përmbajë vetëm emrin apo *brand-in e kazinosë dhe shigjetën* drejtuese të orientuar drejt hyrjes së kazinosë.

2/7. Komisioni i Licencimit miraton formatin dhe rregullat e transmetimit të publicitetit të lejuar të lojërave të fatit, pas marrjes së mendimit të AMA. “

Pika 3 e projektligji shfuqizon pikën 6 të ligjit.

Me këto shtesa e ndryshime të nenit 9 të ligjit është rregulluar publiciteti i lojërave të fatit, ku ndër risit që sjell është publiciteti i aktivitetit të subjekteve të licencuara të lojërave të fatit në vendet ku zhvillohen aktivitetet sportive, si dhe e drejta që kanë këto subjekte për të qënë sponsor në skuadrat sportive.

Në nenin 5 të projektligjit parashikohet shtesa dhe ndryshime të nenit 13 të ligjit si më poshtë:

1. Në shkronjën “a” të pikës 1, të nenit 13 pas fjalëve “... licencon shtohen...nëpërmjet komisionit të licencave...”.

2. Pas shkronjës “h” shtohet shkronja “i” me këtë përmbajtje:

“i) Mbikëqyr nëpërmjet Komisionit të Licencës veprimtarinë e përfituesit nga fondi i posaçëm dhe verifikon nëse përdorimi i fondit është në përputhje me qëllimin dhe termat e projektit”.

Në nenin 6 të projektligjit parashikohet shtesa e nenit 17/1 pas nenit 17 të ligjit me përmbajtjen si më poshtë:

“Neni 17/1

#### Komisioni i Licencave

1. Pranë AMLF-së ngrihet Komisioni i Licencave për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve të paraqitura në lidhje me aktivitetin e lojrave të fatit me këtë përbërje:
  - a) dy përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat;
  - b) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për ekonominë;
  - c) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale
  - d) një përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;
2. Kryetari zgjidhet përfaqësuesi i ministrisë përgjegjëse për financat. Emrat nominalë të anëtarëve të Komisionit të Licencave caktohen me urdhër të titullarit përkatës.
3. Ministrat, sipas parashikimit të pikës 1, mund të caktojnë si anëtarë edhe persona që nuk ushtrojnë funksione publike, dhe që kane jo më pak se 5 vite përvojë pune. Anëtarët e Komisionit caktohen një herë në katër vjet.
4. Anëtarët e komisionit kanë detyrim të nënshkruajnë deklaratën e konfidencialitetit dhe deklaratën e mungesës së konfliktit të interesit, rast pas rasti.
5. Komisioni i Licencave ka këto detyra:
  - a) përcakton mënyrën, kushtet dhe dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e thirrjes për licencimin e subjekteve të cilat organizojnë lojërat e fatit;
  - b) përcakton subjektin e autorizuar të veprë si agjent financiar i subjektit që ka aplikuar/kërkon të pajiset me licencë /kryen aktivitetin e lojës së fatit;
  - c) autorizon subjektet aplikuese për përputhshmërinë e sistemeve që do të përdoren për kryerjen e aktivitetit të lojrave të fatit “baste sportive online” sipas përcatimeve të këtij ligji;
  - ç) administron listat dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion nga AMLF-ja të subjekteve që kanë aplikuar për t’u pajisur me licencë për kryerjen e aktivitetit të lojës së fatit;
  - d) vlerëson plotësimin e kushteve në lidhje me pajisjet dhe personelin për marrjen e licencës dh) shqyrton dhe vlerëson aplikimet për marrje licence;
  - e) harton programet e mbrojtjes së të drejtave të lojtarit që miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për çështjet sociale;
  - ë) mbikëqyr zbatimin e programeve të mbrojtjes së të drejtave të lojtarit;
  - f) kryen funksionin e sekretariatit të Këshillit të Mbështetjes së Projekteve;
  - g) miraton rregulloren e lojës së fatit që propozohet nga organizatori;
  - gj) miraton standardet e specifikimeve teknike për pajisjet e lojërave të fatit sipas parashikimeve të këtij ligji.
  - h) miraton rregulloren në lidhje me standardet, formën dhe mënyrën e publikimit/transmetimin e publicitetit të lejuar të lojërave të fatit nga ana e organizatorëve të lojërave të fatit në median online apo ato audiovizive.
  - i) Kryen funksione të tjera të parashikuara nga ky ligj apo ligje të tjera.
6. Funksionet e asistencës dhe të mbështetjes logjistike të Komisionit të Licencave realizohen

nga AMLF-ja, përmes punonjësve të caktuar që shërbejnë si sekretariat teknik për mbledhjet e Komisionit.

7. Organizimi i punës dhe i veprimtarisë së komisionit bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për financat. Shpërblimi i anëtarëve të Komisionit të Licencave rregullohet sipas legjislacionit në fuqi për caktimin e pagave dhe shpërblimeve dhe mbulohet nga buxheti i AMLF-së.

Në këtë nenë është parashikuar ngritja dhe funksionimi i Komisionit të Licencave për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve të paraqitura në lidhje me aktivitetin e lojrave të fatit, përbërja e këtij komisioni, emerimi i antarëve si dhe detyrat e Komisionit.

Në nenin 7 të projektligjit parashikohet shfuqizimi i shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 18 të ligjit. Shkronja “b” e pikës 5, të nenit 18 të ligjit parashikonte të drejtën që kategoria e “Basteve Sportive” kishte për të ushtruar aktivitetin në pika fizike deri në 1000 adresa sekondare. Duke qënë së projektligji tashmë parashikon që bastet sportive do të luhen online dhe jo në pika fizike sjell si rrjedhojë edhe shfuqizimin e shkronjës “b” të pikës 5, të nenit 18 të ligjit.

Në nenin 8 të projektligjit parashikohet shfuqizimi i fjalisë “Në këtë tarifë është përfshirë e drejta për të hapur deri në 1000 adresa sekondare në total” në shkronjën “a” të pikës 3, të nenit 19 të ligjit.

Ky shfuqizim vjen për arsyen se nuk do të ketë më pika fizike për ushtrimin e aktivitetit për bastet sportive online.

Në nenin 9 të projektligjit parashikohen ndryshime dhe shfuqizime në nenin 20 si më poshtë:

Pika 3 e nenit 20 ndryshohet “3. Bastet sportive online luhen nëpërmjet paisjeve elektronike si Smartphone, Tabletave, Ipad, Laptop por pa u kufizuar vetëm në to, në faqet zyrtare të internetit, aplikacionet e subjekteve të licensuar për ushtrimin e aktivitetit bastet sportive online, dhe vetëm nëpërmjet programeve apo platformave të autorizuara nga komisioni i licencimit, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore”.

Pikat 4 e nenit 20 shfuqizohet pasi parashikonte distancën ndërmjet pikave fizike të ushtrimit të veprimtarisë së basteve sportive.

Pika 5 e nenit 20 ndryshon si vijon: “5. Programet/sistemi/websitet/aplikacionet ku do të luhen bastet sportive online duhet të plotësojnë kushtet dhe standardet minimale të përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat, me propozim të komisionit të licencimit.”.

Duke qënë se aktiviteti i basteve sportive online do të ushtrohet në ëbsitet apo aplikacionet e subjekteve të licencuara në kategorinë e Basteve sportive online do të jetë e nevojshme që këto website apo aplikacione të plotësojnë disa kushte dhe standard minimale, të cilat do të përcaktohen më udhëzim të ministrit përgjegjës për financat.

Në nenin 10, të projektligjit parashikohet ndryshimi i nenit 22 të ligjit në të cilin janë përcaktuar kriteret e licencimit të subjekteve të cilët do të aplikojnë për t’u pajisur me licencë në kategorinë “Baste sportive online”, ku ndër kriteret kryesore janë:

- a) Subjekti aplikues të jetë shoqëri aksionare, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, në objektin e

- veprimtarisë të së cilës të pasqyrohet veprimtaria për lojëra fati në kategorinë “Baste Sportive Online”, me kapital themeltar jo më pak se 20 000 000 (njëzet milionë) lekë;
- b) Subjekti aplikues ose, të paktën, njëri prej aksionarëve të tij të ketë përvojë në fushën e lojërave të fatit ne jo me pak se 3 shtete të BE/OECD dhe per jo me pak se 3 vjet;
  - c) Të ketë kapacitetet e duhura financiare, administruese, organizative dhe besueshmërinë e aplikantit për t’u angazhuar me sukses në projekte të tilla;
  - d) Nëse aksionarët e subjektit aplikues janë individë ata duhet të jenë të pa dënuar penalisht, nuk duhet të jenë në proces gjyqësor për vepra penale, nuk duhet të jetë në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera;
  - e) Subjekti aplikues nuk ka detyrime tatimore të pashlyera.

Në nenin 11, të projektligjit parashikohet riformulime dhe shtesa të nenit 23 si më poshtë:

Në titull, pas fjalëve ...fatit ..shtohen “...baste sportive online”

Fjalja e parë ndryshohet si vijon: “Rregullorja e lojës së fatit baste sportive online propozohet nga organizatori dhe miratohet nga Komisioni i Licencimit.”

Në shkronjen “a”, fjalët ...oraret e funksionimit të sallave të basteve.” shfuqizohen, pasi bastet sportive tashme do të luhen online dhe jo në pika fizike.

Në shkronjën “e” pas fjalës “biletës” shtohet fjala “online”.

Në nenin 12, të projektligjit parashikohen riformulimi i pikës 1 dhe 2, të nenit 24 si më poshtë:

“1. Organizatori, pranon pagesat dhe autorizon tërheqjet për bastet sportive online vetëm nëpërmjet Agjenteve Financiar të Autorizuar. Specifikimet teknike në lidhje me kryerjen e pagesave mënyrën e pranimit apo tërheqjes së tyre kryhet në përputhje me marrëveshjen specifike të organizatorit të lojës së fatit me agentin financiar të autorizuar përkatës, sipas parashikimeve të udhezimit të ministrit përgjegjës për finacat.

2. Me vendim të Keshillit të Ministrave pas marrjes së mendimit të AKSHI përcaktohen standardet që kanë të bëjnë me kushtet teknike të sistemit të basteve sportive on-line, duke përfshirë identifikimin dhe regjistrimin e lojtareve, kërkesat e programeve softëare dhe hardeare, certifikimin e sistemit, procedurat në lidhje me faturat dhe transaksionet e pagesave, parimet e sigurise, dhe kushtet e kontrollit apo mbikqyrjes.”

Në nenin 13, të projektligjit parashikohet riformulimi i shkrojës “d” dhe “dh”, të pikës 3, të nenit 26, si më poshtë:

“d) ka detyrimin të regjistrojë paraprakisht çdo lojtar që do të marrë pjesë në baste sportive online si dhe të marrë e të ruajë të dhëna për identitetin e tyre për të paktën 3 vjet. Ruajtja e këtyre të dhënave të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

dh) Organizatori i basteve sportive online nuk duhet të pranoje para në dorë nga lojtarët, por vetëm nëpërmjet Agjenteve Financiar të Autorizuar sipas këtij ligji.”

Në nenin 14 të projektligjit parashikohet shtesa e neni 27/1, 27/2, 27/3, 27/4 pas nenit 27 të ligjit si më poshtë:

#### Neni 27/1

##### Procedura për dhënien e licencës baste sportive online

1. AMLF publikon në faqen e saj zyrtare të internetit, në 2 gazeta ndërkombëtare si dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, njoftimin për konkurrim për dhënien e licencës për ofrimin e basteve online te cilat jane te kufizuara në numër në rang kombëtar jo mëshume se 10 ( dhjetë),
2. Njoftimi përmban:
  - a) listën e dokumentacionit;
  - b) vendin, datën dhe orën e paraqitjes së dokumenteve;
  - c) gjuhën e paraqitjes së dokumenteve;
  - ç) mënyrën e paraqitjes së dokumenteve;
  - d) vendin, orën dhe datën e shqyrtimit të dokumenteve.”

Në nenin 15 të projektligjit parashikohet shtesa e neni 27/2, 27/3, 27/4 pas nenit 27/1 të ligjit si më poshtë:

#### ““Neni 27/2

##### Procedura e përzgjedhjes së subjektit fitues

1. Përzgjedhja e subjektit kryhet nga Komisioni i Licencimit, në përputhje me kriteret e vlerësimit, afatet, procedurën e konkurimit dhe pikëzimin, të përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat.
2. Anëtarët e Komisionit të Licencave vetëdeklarojnë, nën përgjegjësinë tyre, se pjesëmarrja në këtë komision nuk përbën shkak për lindjen e një konflikti interesi me subjektet pjesëmarrëse në konkurrim. Për mosdeklarim, zbatohen masat e parashikuara në ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.
3. Komisioni i Licencave, brenda 10 ditëve nga përfundimi i procesit të përzgjedhjes miraton listën e pjesëmarrësve në konkurrim, duke renditur, sipas pikëve të marra, aplikantët të cilët plotësojnë kushtet dhe kriteret, sipas këtij ligji. Kandidati, i cili ka marrë numrin më të madh të pikëve, shpallet fitues.
4. Lista e pjesëmarrësve në konkurrim sipas renditjes së parashikuar në pikën 3 dhe njoftimi i fituesit publikohen në faqen zyrtare të AMFL-së.

1. Brenda 10 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të fituesit subjektet pjesëmarrës në konkurrim kanë të drejtë ti paraqesin ankim ministrit përgjegjës për financat për procedurën e zhvilluar.

2. Ministri brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së ankesës përfundon shqyrtimin administrativ dhe njofton ankuesin për vendimin e marrë.

7. Me përfundimin e afatit për paraqitjen e ankesave dhe shqyrtimit të tyre ministri miraton dhënien e licencës, pasi aplikanti i shpallur fitues të ketë paraqitur, brenda 30 ditëve, plotësimin e kriterit të lidhur me fondin e garancisë.

Neni 27/3  
Pezullimi dhe revokimi i licences

Çdo masë që merret lidhur me vijimësinë e procesit pas shqyrtimit dhe propozimit nga Komisioni i Licencimit, ministri përgjegjës për financat e shoqëron me një urdhër të arsyetuar për pezullimin e licencës apo evokimin e saj. Procedura dhe afatet për pezullimin apo revokimin e licencës miratohen me VKM.”

“Neni 27/4  
Ndryshimi i të dhënave

Mbajtësi i licences është i detyruar të njoftojë AMFL-në, brenda dhjetë ditëve pune, për të gjitha ndryshimet dhe devijimet nga masat e planifikuara më herët në planin e zhvillimit të aktivitetit. Subjekti i licencuar i drejtohet AMFL-së me një informacion me shkrim, duke përshkruar çdo fakt e rrethanë që ka sjellë ndryshime apo devijime nga planifikimi. AMFL-ja mbikëqyr veprimtarinë e subjektit të licensuar dhe informon ministrin përgjegjës për financat duke zbatuar parashikimet e këtij ligji.”.

Në nenin 16 të projektligjit parashikohet shtesa dhe ndryshime të nenit 28 të ligjit si më poshtë:

1. Fjala e parë e pikës 1, ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Licenca për të drejtën e organizimit të lojërave të Lotarisë Kombëtare jepet për një periudhë 10-vjeçare dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat , në përputhje me parashikimet e këtij ligji. Për këtë kategori loje do të jepet vetëm një licencë.”.

2. Në shkronjën “c”, të pikës 3 fjala “sekondar” hiqet.

Në nenin 17 të projektligjit parashikohet shtesa dhe ndryshime të nenit 29 të ligjit si më poshtë:

Pikat 1 dhe 2, riformulohen me këtë përmbajtje:

“1. AMLF-ja shpall hapjen e garës për dhënien e licencës për Lotarinë Kombëtare, pas autorizimit të dhënë me urdhër të ministrit përgjegjës për financat.

2. Ministri përgjegjës për financat miraton kriteret e vlerësimit të garës dhe dokumentet standarde për dhënien e licencës për Lotarinë Kombëtare.”

b) Në pikën 3, togfjalëshi “...autoriteti i autorizuar nga Këshilli i Ministrave për organizimin e garës...”, zëvendësohet me “... AMLF-ja...”.

Në nenin 18 të projektligjit parashikohet shtesa dhe ndryshime të nenit 30 të ligjit si më poshtë:

Në pikën 1, togfjalëshi “...autoriteti i autorizuar nga ligji ...”, zëvendësohet me “... AMLF-ja...”.

Në shkronjën “c”, të pikës 2, togfjalëshi “ ... 1 200 000 000 (një miliard e dyqind milionë)...” bëhet “...40 000 000 (dyzet milionë)...”;

Në shkronjën “dh”, të pikës 2, togfjalëshi “...këtë veprimtari...” bëhet “...lojërat e fatit...”.

Në shkronjën “ë”, të pikës 3, dhe në pikën 4, emërtimi “...Komisioni i Vlerësimit të Ofertave...” bëhet “...Komisioni i Licencave...”

Në nenin 19 të projektligjit parashikohet shtesa dhe ndryshime të nenit 31 të ligjit si më poshtë:

Pika 1 riformulohet me këtë përmbajtje:

“1. Përzgjedhja e subjektit për lojërat e fatit Lotari Kombëtare bëhet nga Komisioni i Licencimit, në përputhje me kriteret e vlerësimit, të përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat.”

Në pikën 2, fjalia e parë riformulohet me këtë përmbajtje:

“Anëtarët e Komisionit të Licencimit duhet të vetëdeklarojnë, nën përgjegjësinë tyre, se pjesëmarrja në këtë procedurë përzgjedhëse konkurrimi nuk përbën shkak për lindjen e një konflikti interesi me subjektet pjesëmarrëse në konkurrim.”

Në pikën 3, , emërtimi “...Komisioni i Vlerësimit të Ofertave...” bëhet “...Komisioni i Licencave...”

Në pikën 4, togfjalëshi “...autoriteti i autorizuar nga ligji ...”, zëvendësohet me “... AMLF-ja...”.

Në nenin 20 të projektligjit parashikohet shtesa dhe ndryshime të nenit 32 të ligjit si më poshtë:

Pikat 1 dhe 2, riformulohen si më poshtë vijon:

“1. Pas miratimit të listës së pjesëmarrësve në konkurrim AMLF bën publikimin e njoftimit të fituesit në faqen zyrtare të internetit të AMLF-së. Brenda 30 ditëve nga data e publikimit të njoftimit, aplikanti ka të drejtë të paraqesë ankim ministrit përgjegjës për financat në lidhje me procedurën e zhvilluar.

“2. Ministri përgjegjës për financat, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së ankesës, përfundon shqyrtimin administrativ dhe njofton ankuesin për vendimin e marrë.”

Në pikën 3, togfjalëshi “...autoriteti i autorizuar nga ligji ...”, zëvendësohet me “.. ministri përgjegjës për financat...”

Në nenin 21 të projektligjit parashikohet që në pikat 2 dhe 4, të nenit 33 të ligjit , fjalët “...Këshilli i Ministrave...” bëhen “...ministri përgjegjës për financat...”.

Në nenin 22 të projektligjit parashikohet shtesa dhe ndryshime të nenit 36 të ligjit Shkronja “d” e pikës 6 riformulohet si vijon: “d) dëshmi penaliteti të dorëzuar nga aplikantët /administratorët, ortakët e shoqërisë dhe pronarët përfitues në momentin e aplikimit, vërtetime që nuk janë në proces gjyqësor, që nuk janë dënuar penalisht me një vendim të formës së prerë për vepra penale në fushën e krimit ekonomik, evazionit fiskal dhe/apo doganor, shpërdorim detyre, mitmarrje apo mitdhënie, vjedhje, trafik lëndësh narkotike apo armësh, eksplozivësh, mospagim gjobash apo për vepra të tjera penale që kompromentojnë personat në nderin e personalitetin e tyre.”

Në pikën 6, pas shkronjës “ë” shtohet shkronja “f” me këtë përmbajtje: “f) Deklaratë që subjekti aplikues nuk ka ortakë/aksionarë, përfaqësues ligjorë ose anëtarë të organeve drejtuese të veta, individë apo persona që kanë qenë ortakë/aksionarë, përfaqësues ligjorë, anëtarë të organeve drejtuese të subjekteve të lojërave të fatit, pronar përfitues apo persona të lidhur që rezultojnë të dënuar penalisht me një vendim gjyqësor të formës së prerë, për veprat penale të parashikuara në ligj.”

Në nenin 23 të projektligjit parashikohet shfuqizim i pikës 2 të nenit 46 të ligjit. Në nenin 46 pika 2 të ligjit parashikohet autorizimi që jep AMLF për subjektet që do të zhvillojnë programet software për kategorinë “Baste Sportive”. Ky shfuqizim vjen si rredhje pasi projektligji ka parashikuar që këtë miratim të sistemeve që do të pëdoren nga subjektet nga Komisioni i Licencimit.

Në nenin 24 të projektligjit parashikohet bëhen këto ndryshime të nenit 47 të ligjit si më poshtë:

1. Pas paragrafit të parë të pikës 1 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Për krijimin e garancive për fituesit e lojërave të fatit, organizatori i kategorisë “Baste sportive online” është i detyruar të ngurtësojë një fond prej 120 000 000 (njëqin e njëzet milionë) lekësh, por jo më pak se 5% e shumave të vëna në dispozicion të lojës nga ana e lojtarëve brenda një viti ushtrimor paraardhës, në një llogari të veçantë bankare, në favor

të Ministrisë së Financave, i cili zhbllkohet vetëm me urdhër të ministrit përgjegjës për financat.

2. Pas paragrafit të parë pikës 2 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Për krijimin e garancive për shlyerjen e detyrimeve periodike karshi AMLF-së, organit tatimor etj, organizatori i kategorisë “Baste sportive online” është i detyruar të ngurtësojë një fond prej 50 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, në një llogari të veçantë bankare, në favor të AMLF-së, i cili zhbllkohet vetëm me urdhër të ministrit përgjegjës për financat .

Në nenin 25 të projektligjit parashikohen shtesa dhe ndryshime në nenin 52 të ligjit si më poshtë:

“Pika 3 ndryshon si vijon: “3. Organizatorët e kategorisë “Baste sportive online” nuk taten sipas pikës 2 të këtij neni, por derdhen në llogari të Fondit të Posaçëm masën 15 % të të ardhurave bruto nga loja.”

Sipas këtij ndryshimi organizatorët e Basteve sportive online do të derdhen në llogari të Fondit të Posaçëm masën 15 % të të ardhurave bruto nga loja e cila do të përdoret për financimin e projekteve në fushën e sportit, kulturës, inovacionit.

Paragrafi 2 i pikës 4 riformulohet:

“Krahas detyrimit tatimor të përmendur në pikën 2 dhe 4 të këtij neni, organizatorët e kategorive “Kazino”, “Kazino në hotele me 5 yje” dhe “Resort kazino”, brenda 31 marsit të vitit pasardhës derdhen në llogari të Fondit të Posaçëm shumën 0.4 për qind të xhiros vjetore.”

Pika 9 riformulohet si vijon:

“9. Organizatori i kategorisë "Lotari Kombëtare", brenda 31 marsit të vitit pasardhës krahas detyrimeve të parashikuara në këtë nen, duhet të derdhë në llogari të Fondit të Posaçëm shumën 5,4 për qind të xhiros vjetore”.

Në pikën 10, fjalët “... ministrisë përgjegjëse për kulturën...”, zëvendësohen me “...Fondit të Posaçëm...”.

Pas pikës 12 shtohet pika 13 me këtë përmbajtje:

“13. Organizatorët e kategorive “Baste sportive online”, “Bingo televizive” dhe “Lotari Kombëtare” krahas detyrimit tatimor të parashikuar në këtë nen derdhen në llogari të Fondit të Posaçëm edhe 15 % të shumës së deklaruar për publicitetin e kryer në përputhje me parashikimet e këtij ligji.”

Ndryshimet e pikave 4, 9 e 10 si më sipër konsistojnë në faktin që subjektet e lojërave të fatit që sipas përcaktimeve të ligjit kishin detyrimin të derdhen një vlerë të caktuar të xhiros vjetore në llogari të ministrive përgjegjëse për sportin, kulturën dhe turizmin tashmë këto vlera do të derdhen për llogari të Fondit të Posaçëm.

Deri në vitin 2018 vit në të cilin kanë operuar në tregun e lojërave të fatit kategoria e “Basteve sportive” janë arkëtuar në buxhetin e shtetit nga të gjitha llojet e tatimeve rreth 2 miliard lekë, ku 1.6 miliardë janë të ardhura nga tatimi mbi lojrat e fatiti.

Në nenin 26, të projektligjit parashikohet shtesa e nenit 52/1 dhe 52/2 pas nenit 52 të ligjit si më poshtë:

#### “Neni 52/1

##### Fondi i posaçëm

1. Të ardhurat e përfituara nga zbatimi i këtij ligji shërbejnë për krijimin e Fondit të Posaçëm si një zë më vete në buxhetin e AMLF-së që përdoret me vendim të Këshillit të Mbështetjes së Projekteve.
2. Ky fond shërben për mbështjetjen e projekteve në fushën e sportit, kulturës, inovacionit dhe teknologjisë së inovacionit, në bazë të kërkesës për financimin e projekteve të paraqitura nga institucionet shtetërore, pas marrjes së mendimit të institucioneve publike të fushës.
3. Burimet e financimit të fondit janë:
  - a) Të ardhurat e krijuara sipas parashikimit të nenit 52;
  - b) Financime vendase apo të huaja, të cilat burojnë në mënyrë të ligjshme nga organizata publike, private ose persona fizikë;
4. Rregullat të hollësishme për mënyrën e administrimit dhe përdorimit të Fondit të Posaçëm përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### “Neni 52/2

##### Këshilli i Mbështetjes së Projekteve

1. Këshilli i Mbështetjes së Projekteve, më poshtë “Këshilli”, ngrihet pranë AMLF-ë si organ kolegjial që vepron në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike.
2. Kryetar i Këshillit është Zëvendës Kryeministri dhe anëtarë janë ministri përgjegjës për financat, ministri përgjegjës për sportin, ministri përgjegjës për kulturën, ministri përgjegjës për çështjet sociale, ministri përgjegjës për inovacionin, Kryetari i Federatës Kombëtare të Futbollit, Kryetari i Komitetit Olimpik Shqiptar, titullari i institucionit të teknologjisë së informacionit.
3. Komisioni i Licencës vepron si sekretariat teknik i Këshillit dhe e mbështet atë për përmbushjen e detyrave të parashikuara nga ky ligj.
4. Rregulla të hollësishme mbi organizimin dhe funksionimin e Këshillit, kushtet dhe kërkesat për financimin e projekteve, dokumentacioni dhe procedura e shqyrtimit dhe e vlerësimit të projekteve nga Këshilli i Mbështetjes së Projekteve, monitorimi i zbatimit të projekteve miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Në nenin 27, të projektligjit parashikohet riformulim të shkronjave “gj” dhe “k” të pikës 1.2, të nenit 53, si më poshtë:

“ gj) organizatorët që ushtrojnë aktivitetin e lojërave të fatit të basteve sportive online përdorin programe software dhe sisteme, të paautorizuara nga AMLF-ja për këtë qëllim;

k) subjekti nuk ka paguar brenda afateve të parashikuara në ligj shumat përkatëse për Fondin e Posaçëm sipas nenit 52 të ligjit”.

Në nenin 28, të projektligjit parashikohet që në nenin 59 pas pikës 3, të shtohet pika 4 si më poshtë:

“4. Ngarkohet ministri përgjegjës për Financat për nxjerrjen e udhëzimit për përcaktimin e procedurave të konfiskimit, magazinimit dhe shkatërrimit të mjeteve të lojërave të fatit”.

Duke qënë se në ligj ka patur një boshllik ligjor në lidhje me procedurën e konfiskimit, magazinimit dhe shkatërrimit të mjeteve të lojërave të fatit është parashikuar që kjo procedurë të detajohet në një udhëzim të ministrit përgjegjës për Financat.

Në nenin 29, të projektligjit parashikohen ndryshime të nenit 71 të ligjit si më poshtë:

“1. Në pikën 2/1 pas fjalës ..”kategorive” hiqet togfjalëshi “baste sportive “.

2. Në fund të pikës 2/2 shtohen fjalët “baste sportive *on-line*.”.

Në nenin 30 parashikohet hyrja në fuqi e ligjit.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ AKTI**

Për zbatimin e këtij akti ngarkohet Ministria përgjegjëse për Financat dhe Ekonomikë, Ministria përgjegjëse për Çështjet sociale, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Ministria përgjegjëse për Arsimin dhe Sportet dhe Autoriteti i Mbikqyrjes së Lojarve të fatit.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-AKTIT**

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe i dërgohet për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Kulturës, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe Bankës së Shqipërisë

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Miratimi dhe zbatimi i këtij projektligji parashikohet të sjellë efekte pozitive financiare në buxhetin e shtetit në masën rreth 2 miliardë në miliardë lekë.

**MINISTËR**

**Delina Ibrahimaj**